



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e tretë - III e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 04.04.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete. Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkyrytar i Komunës, Fatlum Berisha - Drejtore për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtore për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtore për Kulturë, Rini dhe Sport, Parayll Zogjani - Drejtore për Planifikim Urban dhe Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

R E N D D I T E

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.02.2024.
2. Propozim për ndryshimin e vendimeve Nr. 27, të datës 04.03.2024 dhe Nr. 31, të datës 07.03.2024.
3. Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023.
4. Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.
5. Propozim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim në bujqësi.
6. Propozim për formimin e Komisionit për Zëvendës Drejtore shkollës në Fushë-Kosovë.
7. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 07, të datës 07.02.2024 për lejimin e mjeteve financiare për punëtorët arsimorë.
8. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal dhe zbatueshmërinë e Hartës Zonale të Komunës.
9. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme, si dhe paraqiti për shqyrtim dy rekomandime nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, ‘Kërkesën për shfuqizimin e vendimit nga mbledhja e muajit janar 2023, për aprovimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave’ dhe ‘Propozimin për përkrahjen financiare të nënave lehona’. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kërkojmë që të përkrahet, propozimi ynë nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa për përkrahjen financiare të nënave lehona, që u cekë këtu nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, por nuk pajtohem me vodosjen arbitrale të pikave të rendit të ditës, sepse kemi pasur raste kur një pikë e caktuar nuk ka kaluar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por është shqyrtuar dhe vodosur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës. Nuk pajtohem me lëvizjen e pikës ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’ në fund të mbledhjes, sepse atëherë anëtarët e Ekzekutivit të Komunës, nuk qëndrojnë fare në sallën e Kuvendit të Komunës. Nuk dua të tingëlloj këtu si kërcnues, kemi raste kur vendimet e kthyera si të kundërligjshme janë lënë në fuqi, me votat e shumicës, apo mos pjesëmarrjen e tyre në votim. Ne kemi mundësi si opozitë që përdorim edhe mënyra tjera të përballje, këtu në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, andaj kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të mos lëvizet, ta ruajmë atmosferën e mirë në Kuvendin tonë, sepse ne mund të veprojmë edhe ndryshe.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu duhet të tregohet një seriozitet, të mos lëvizet në fund pika e ‘Pyetjeve dhe përgjigjeve parlamentare’, pa kur farë arsyen sepse ne e kemi miratuar unanimisht këtu ‘Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’, jemi dakorduar për disa pika tonat, për pikat e Ekzekutivit të Komunës, me formulimin e standardizuar në plan, ju këtë punë edhe mund ta ndryshoni këtu me vota të shumicës parlamentare, por duhet të jeni të vetëdijshëm, se po ndikoni në mbylljen e një dritare për anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe do të bëheni pjesë e kërkesave të Ekzekutivit të Komunës, kujt po i intereson kjo punë, është e quartë, tani ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, duhet të jeni më i quartë në qëndrimin tuaj, sepse në këtë mënyrë po e prishni punën e qetë në Kuvendin e Komunës, neve nuk po na lejoni reagimin e qetë dhe të arsyeshëm, na nuk e kemi ndonjë problem, sepse kemi të drejtë të përdorim metodat demokratike, bllokimin e punës së Kuvendit të Komunës, e jo për punën tonë të vendos dikush lartë në zyre, të dikton punën tonë këtu në sallën e Kuvendit të Komunës. Ndërsa për propozimin e paraqitur dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa nga anëtarë z. Vlonjat Hasani, për përkrahjen financiare të nënave lehona, ne këtë punë e kemi shqyrtuar në hotelin ‘Sharr’, kur kemi punuar me Grupet Punuese në disa rregullore komunale, por fokusimi ynë ka qenë te rregullorja për ndarjen e subvencioneve, ku është trajtuar kjo çështje dhe shumë çështje tjera. Ne jemi për përkrahjen e këtij propozimi, por pasi të analizohet mirë kjo punë, edhe nga ana e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, sa i përket anës financiare.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani është mbledhja e dytë e Kuvendit të Komunës, që po shkelet ‘Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’, për të cilin në dy takime tona jemi dakorduar të gjithë përmbytjen e tij, unë dua ta kem një sqarim të bazës ligjore, për vodosjen në këtë mënyrë të rendit të ditës nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në kundërshtim me vendimin e unifikuar për planin e punës, ne e kuptojmë shumë drejtë, që Ekzekutivi i Komunës i paraqet pikat e veta për shqyrtim, këtë mundësi e kanë në pikën e tretë të planit, ne kërkojmë që ju të frenoheni në këtë punë, të mos luani me durimin tonë, sepse ne jemi asambleistë të zgjedhur me votën e popullit, aq sa kemi marrë vota secili nga

ne këtu, ju nuk mund të bëni çka të doni, ose duhet ta bëni propozimin për shfuqizimin e planit të punës, ju këtë mund ta bëni me Grupin tuaj parlamentarë dhe partnerët e juaj, po unë pyetjet e mia do t'i parashtroi në pikën e dytë të rendit të ditës, andaj kërkoi nga ju Kryesues i Kuvendit të Komunës që të mos ndërhyjni, sepse ju tani po e shkelni ‘Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’, nuk jeni vetë vetja, mos na qitni neve në vështirësi, me udhëheqjen tuaj të Kuvendit të Komunës, unë tani po e grisi këtu planin e punës, nuk vlen, asgjë, sepse ai nuk po respektohet nga ana e juaj, edhe pse është votuar me votim unanim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Nënkyetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë do të jap disa sqarime, po së pari kërkoi nga ana e juaj, që ta mban një minutë heshtje për 168 dëshmorët dhe martirët e Komunës së Fushë-Kosovës, ku bënë pjesë edhe dëshmori ynë për liri z. Imer Sfarqa, sepse sakrifica e tyre është diçka e pa ndashme në punën dhe në përditë shmërinë tonë. Unë i dëgjova qëndrimet e juaja, tani ne kërkojmë që ky rend i ditës të përkrahët, sipas radhitjes së pikave për shqyrtim të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës, ndërsa sa i përket ‘Propozimit për përkrahjen financiare të nënave lehonë’, ne duhet ta bëjmë një grup për vlerësimin e kostos financiare, sepse ky vendim ndikon në të ardhmen, duhet të jetë i planifikuar mirë, ne këtë punë e kemi diskutuar edhe në Grupin Punues, që u cekë këtu nga anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Mirsad Qyqalla, ku kanë kontribuar edhe anëtarët tjera z. Durim Hajra dhe drejtoret e komunës, këtë punë duhet ta trajtojmë në ‘Rregulloren tonë për kushtet dhe kriteret për ndarjen e subvacioneve’, aty kemi punuar së bashku, këtu së pari na mungojnë informatat bazike, për numrin e nënave lehonë, mendimi im është se me këtë punë duhet të merret Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pavarësisht mendimeve tona dhe diversitetin në qasjen e kësaj pune nga subjektet politike në Kuvendin e Komunës, në parim, ne jemi që kjo punë të zgjidhet pas një analize financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit, sepse në komunën tonë kjo punë dallon në shumë aspekte. Unë jam këtu për t'iu dëgjuar juve deri në fund të mbledhjes, do të përgjigjem në pyetjet tuaja, por ne duhet t'iu japim prioritet propozimeve, që jasin efekt juridikë dhe ndihmojnë Administratën e Komunës në punën e saj, unë i dëgjoi fjalimet e juaja se anëtarët e Ekzekutivit të Komunës, nuk qëndrojnë deri në fund të mbledhjes, por unë do të jem sot këtu me shumicën e Drejtoreve të Drejtorateve të Komunës.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për të pritur rregullimin e kësaj çështje me rregullore, ne e njohim dhe jemi dëshmitar të mënyrës së punës së Ekzekutivit të Komunës dhe funksionimit të Komunës së Fushë-Kosovës, por ka pasur edhe raste tjera, kur ato janë rregulluar me vendim, e dijm që edhe për punën e varrezave në fshatin Miradi e Epërme, është marrë vendimi para gjashtë viteve, por nuk është realizuar kurrë. Subvencionimi i lehonave është i njëjtë për të gjithë, krijon barazi, komuna jonë ka mundësi financiare ta bënë këtë punë, një praktikë ju e keni aplikuar, edhe për subvencionimin e fermerëve, me kërkesën se po përkrahen ekonomitë familjare, subvencionimi i lehonave do t'i shërbente të gjitha familjeve tona. Kërkesa jonë si Grup Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, është që pika e ‘Pyetjeve dhe përgjigjeve parlamentare’, të kthehet si pikë e dytë e rendit të ditës, aty ku ka qenë.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pse keni ndërhyrë në pikën e ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, kur këtë punë me pajtim unanim e kemi rregulluar me ‘Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’, kemi pasur një bashkëpunim, me çfarë bazë është lejuar ky ndërrim, meqë këtë punë ne e kemi stërvit diskutuar, jemi pajtuar edhe për minutat që duhet të kemi secili, kemi kërkuar që kjo punë të respektohet nga secili Grup Parlamentarë dhe secili anëtarë i

Kuvendit të Komunës, unë kërkoj që në këtë punë ta kemi një respekt reciprok dhe ‘Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’, të zbatohet ashtu sikur është miratuar, me votimin unanim në Kuvendin e Komunës.

Shpend Bardiqi: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Unë në qëndrimin e pushtetit lidhur me pikën ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, e shoh një zbutje të tyre, ata kanë mundur të hiqni edhe krejt, kjo është pozitive, unë ju inkurajoi ta hiqni, sepse gjendja e përgjithshme e Komunës së Fushë-Kosovës nuk ndërron, ka rrezik të rrëzohen dritaret në objektin e komunës, në secilin kënd ka merimanga, për tri vite e ndërtojmë një etazh, sikur është kati i dytë i komunës, madje pa kryerjen e të gjitha punëve nga punë kryesi, nëpër zyre janë vendosur punëtorët e komunës, sepse ne çka dojmë bëjmë. Pak mua po më pëlqen që jeni zbutur, kjo u tha edhe në qëndrimin e Nënkyetarit të Komunës, i cili tha se prioritet duhet të japim propozimeve me ndikim juridikë, na duhet të votojmë shpejt propozimet tjera, të arrijmë te pika e pyetjeve. U tha se çështja e përkrahjes financiare të nënave lehona, do të bëhet me rregullore, pas analizimit të aspektit finanziarë, por ju e keni marrë edhe vendimin për përkrahjen financiare të qytetarëve të infektuar me Covid - 19, por nuk e keni zbatuar, sepse numri është rritur shumë, ky është serioziteti i qëndrimit tuaj. Ne kemi një mbetje të buxhetit prej gjashë milion eurove dhe kjo punë nuk është e mirë, sepse mundësi financiare për përkrahje komuna ka, por mungon vullneti politikë. Për këtë çështje nuk do të shpenzohet as 5% e këtij buxheti të pa shpenzuar, që na ka ardhur prapë, sikur ka ndodhur vitin e kaluar me ‘Rregulloren për bonuset e ndërtimit me kompenzim’, kërkojmë që ta marrim këtë vendim për subvencionimin e nënave lehona, sikur i kemi marrë edhe shumë vendime tjera ‘Ad hon’, andaj kërkoj që propozimi ynë të qitet në votim, të përkrahet dhe të hyn në rendin e ditës për shqyrtim.

Durim Hajra: Unë e kam obligim për ta sqaruar propozimin, u tha se në parim edhe ne e përkrahim këtë punë, andaj e kërkojmë mendimin e Drejtorit të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, për të ditur a kemi buxhet, kjo punë zgjidhet me një vendim nëse ka vullnet politikë, pastaj bartet si çështje në Rregulloren e subvacioneve. Pyetjet duhet të rikthehen në vendin e tyre, si pikë e dytë, ashtu sikur është planifikuar me ‘Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’.

Nënkyetari i Komunës: E vërteta është se ju e keni miratuar një plan të punës, që shërben si orientim për punën tuaj, por sipas dispozitave të ‘Ligjit për Vetëqeverisje Lokale’, rendin e ditës për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cakton Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ndërsa për atë rend të ditës të propozuara, me votim vendos në fund Kuvendi i Komunës, andaj unë nuk do t’i kthehem më kësaj çështje. Ndarja e subvacioneve bëhet me planifikim buxhetor vjetor, te lehonat kjo punë ndryshon, ne duhet të kemi një qëndrim, a do t’i përkrahim vetën rastet që janë nën asistencën sociale, kjo punë kur fillon duhet të analizohet mirë, qëndrueshmëria financiare dhe mbulueshmëria buxhetore nëpër vite, ne këtë punë mund ta bëjmë në fshatra, por është më vështirë ta bëjmë në qytetin tonë, me një strukturë të ndryshme të popullsisë. Për punë me interes publikë, ne mund të mbajmë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, kjo pjesa e lehonave nuk është e planifikuar me buxhetin e vitit 2024, thjeshtë ne këtu nuk mund ta bëjmë një kalkulim ‘Ad hoc’, u përmend këtu shembulli me pandeminë, por koha e pandemisë ka qenë kaluese, kjo punë kur vendoset mbetet dhe duhet të planifikohet me buxhet, unë nuk jam që të marrim vendime, pa një vlerësim financierë të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Radhitjen e punës nuk e caktojmë këtu as ne si asambleistë, as Nënkyetari i Komunës, por propozimet jemi të obliguar t'i analizojmë, aq sa mundemi dhe t'i qesim në votim sipas ‘Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës’, andaj ju lus të gjithëve, që të jeni të qartë në qëndrimet tuaja, të mos zgjateni.

Hasan Ismajli: Unë nuk besoi që rendi i ditës është ndryshuar pa qëllim, ne këtu jemi njëzet e shtatë asambleistë, nuk duhet ne të jemi në mëshirën e Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, meqë plani i punës nuk vlen, unë e kam shqyer atë këtu në mbledhje, meqë ju nuk e vlerësoni si plan të punës së një organi të komunës.

Shpend Bardiqi: Urgjenca, këtu ideja është se ky propozim mund të përkrahet edhe në parim, si një rregullim paraprak, po aludohet se këtu mund të ndikon edhe regjistrimi i popullsisë, që mund të ketë ndikim në komunën tonë, ne me regjistrimin e popullsisë, do të fitonim në shumë dimensione, ne ndoshta mund të kemi edhe njëzet mijë banorë më shumë, por me këtë fakt neve si komunë na rritet buxheti.

Aida Alimi: Unë jam në vitin e njëmbëdhjetë si anëtare e Kuvendit të Komunës, gjithmonë e kemi pasur një praktikë të hartimit të planeve vjetore të punës, që na kanë shërbyer neve si asambleistë për përgatitjen tonë, sepse ne nuk jemi profesionistë, por përgatitemi në bazë të materialit të dorëzuar për shqyrtim dhe vendim marrje. Unë kërkoi që vendimi për lehonat të zbatohet.

Vlonjat Hasani: Ne kërkojmë që të mbështeten gratë lehona. Rendi i ditës është pikënisja e veprimeve tona dhe me planin e punës, ne e dijm orientimin për një mbledhje, ky është Kuvendi i dytë, që pyetjet zhvendosen në fund të rendit të ditës, këtu janë ndal edhe vendimet e kundërligjshme.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e përkrahim ‘Propozimin e Kryetarit të Komunës për shqyrtimin e ‘Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave’, shfuqizimin e vendimit të janarit 2023 për miratimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave’, e tha shumë qartë Nënkyetari i Komunës, se rendin e ditës për mbledhje të Kuvendit të Komunës, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, e cakton Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, këtu nuk ka asnje tendencë për mbyllje të debatit, sepse e theksoi Nënkyetari i Komunës, se do të qëndron në mbledhje, për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve tona, sepse ju të gjithë e dini se pas parashtrimit të pyetjeve këtu në sallë, disa asambleistë as përgjigjet në pyetjet e tyre, nuk i kanë pritur. Këtu e kemi edhe një ‘Rekomandim shtesë për përkrahjen financiare të nënave lehona’, por pa asnje dokument financiarë, u përmend këtu edhe ‘Bartja e gjashtë milion eurove të pa shpenzuara’, por aty as 10% e tyre nuk kalon te kategoritë tjera ekonomike, shumica janë të destinuara për investime kapitale, janë mjete financiare të destinuara për shpenzime, ku shumica e tyre janë mjete financiare të kontraktuara dhe do të realizohen, pas bartjes së buxhetit nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, nëse ato nuk vonohen sikur vitin e kaluar, deri në muajin gusht.

Mirsad Qyqalla: Unë bashkë me Shefin e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Laureat Gojnovci, jemi pajtuar për planin e punës, e kujt është kjo tendencë për mbylljen e debatit, një grup i asambleistëve këtu nuk mund të vazhdojmë në mënyrë normale, sikur nuk ka ndodhur asgjë, ne nuk po dëshirojmë që Kuvendin e Komunës që e ka pasur një atmosferë të mirë në punë, ta shndërrojmë në një vend, ku ka zhurmë. Ju po e shihni investimin këtu në sallën e Kuvendit të Komunës, ne jemi pajtuar që koha të respektohet, dihet kush nuk e respekton kohën e caktuar sipas ‘Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës’, tani ju këtu, me këtë mënyrë dhe

qasje të veprimit, pak po e teproni, ju këtë me votë edhe mund ta bëni, por kjo punë nuk është në rregull, por e paraqet një vendim arbitrar të partisë në pushtet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani i fton anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësit tjerë në sallë, që ta mbajmë një minutë heshtje, për nderimin e dëshmorëve dhe martirëve të Komunës së Fushë-Kosovës, që e kanë dhënë jetën për çlirimin dhe lirinë e vendit tonë.

- U mbajtë një minutë heshtje për nderimin e dëshmorëve dhe martirëve të Komunës së Fushë-Kosovë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim ‘Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023, për miratimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, gjashtë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovon për shqyrtim ‘Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023, për miratimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim ‘Propozimin për përkrahjen financiare të nënave lehona’.

U votua me: dhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej dhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ‘Propozimi për përkrahjen financiare të nënave lehona’, nuk kalon në mungesë të pjesëmarries së anëtarëve të Kuvendit të Komunës në votim.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim rendin e ditës së propozuar për shqyrtim me bashkëngjitjen e ‘propozimit për shfuqizimin e vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023, për miratimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, dhjetë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës më shumicë të votave e aprovon rendin e ditës së propozuar, me shqyrtim ‘Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023, për miratimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.02.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtim për aprovim ‘Ekstraktin e Prosesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.02.2024’, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Pas diskutimeve, sqarimeve dhe mospajtimeve, ndërmjet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Shefit të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës z. Mirsad Qyqalla - lidhur me zhvillimin e procesit të vendim marries dhe vendosjes së propozimeve në votim, duke mos e vendosur në votim ‘Kërkesën për kthimin e pyetjeve dhe përgjigje parlamentare’, në pikën e dytë të rendit të ditës, anëtarët e Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, e lëshuan mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Durim Hajra: Këtu debati zgjati, nuk u zbatua logjika e argumenteve dhe rrjedhës së diskutimeve, ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, në këtë rastë jeni i pa sinqertë, jeni në kundërshtim me ligjin, të cilin po e shkelni, po e zbatoni qëndrimin e Ekzekutivit të Komunës, po e dëmtoni transparencën, duke mos i vendosur në votim të gjitha propozimet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Ju nuk po ndërmerrni asgjë për ta respektuar Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, ajo që vlen për disa pika, nuk vlen për pika tjera, ju tani me veprimet e juaja, po e shkelni ligjin dhe rregulloren me të madhe dhe jeni i pa sinqertë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë këtu sot nuk e kam fyer askënd, madje vetë Kryesueses së Kuvendit të Komunës znj. Vjollca Konjusha i kam kërkuar falje, për sjelljen time dhe debatin në mandatin e kaluar nga pozita e asambleistikët, për çështjen e audio - incizimeve dhe mikrofonave, kur kam ardhur në këtë pozitë e kam kuptuar, se ku problem nuk mund të zgjidhet nga unë, tani këtu unë vetë punën time e kam bërë, në takimin me përfaqësuesit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku prezentë ka qenë edhe Zyrتari I Lartë për Kuvend dhe Komitete z. Hasan Gjyrevcı, pastaj në takime me përfaqësuesit e Demos-it, ju kam përkrahur edhe në kërkesën tuaj për ndihmë nga një Organizatë Jo Qeveritare, lidhur me ndihmën për rregullimin e mikrofonave dhe publikimit të audio incizimeve, por unë pajtohem 100% se ‘Ligji për Vetëqeverisje Lokale’, është shkelur, por nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, unë e kam bërë atë që më takon mua, tani jemi këtu, realizimi i kësaj punë është në kompetencën e Ekzekutivit të Komunës, unë nuk po e kuptoi, ku qëndron këtu pa sinqeriteti im.

Durim Hajra: Tani ne jemi duke diskutuar për një orë, për atë që e thotë ligji dhe rregullorja, ne kemi shqyrtuar edhe vendime tjera, pa material të plotë, madje materiali është dorëzuar në ditën e mbledhjes së Kuvendit të Komunës. Në rastet tjera, po të mos kishte ndodhur kjo punë asnjëherë, unë nuk do ta kisha përmendur fare këtë çështje.

Hasan Ismajli: Zhvendosja e pikës së ‘Pyetjeve dhe përgjigjeve parlamentare’, neve këtu po na humb shumë kohë, këtë punë e keni shkaktuar vetë ju. Unë e kam një vërejtje për përmirësim në faqen numër dhjetë te ekstraktit të procesverbalit, në diskutimin tim unë kam thënë se në ‘Sheshin Dardania’, që nuk është ndërtuar asnjëherë, ajo është rrugë, por edhe në disa rrugë tjera të kësaj lagje, do të mbilen 1500 fidane, jo 150 sikur është në procesverbal, sepse një pemë e tillë dekorative kushton 466.00€, kjo lëndë kam informata se do të shkon edhe në krime ekonomike dhe do të hetohet nga Prokuroria e Shtetit, sikur ka qenë rasti edhe me tokën e uzurpuar komunale, të shndërruar pastaj në pronë private, në atë pjesë të qytetit tonë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.02.2024’, me vërejtjen e cekur nga anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota ‘për’, pesë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave anëtarët e Kuvendit të Komunës e aprovuan ‘Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.02.2024’, me vërejtjen e cekur nga anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

Pika e dytë (2) - Propozim për ndryshimin e vendimeve Nr. 27, të datës 04.03.2024 dhe Nr. 31, të datës 07.03.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani i kemi për diskutim dy kërkesa për arsyet e gabimeve të lëshuara në vendimet e marra në numra dhe emërtimin e programeve apo nën-programeve për ‘Propozimin përritjen e të hyrave vetjake për vitin 2023’ dhe propozimin përbartjen e buxhetit të pa shpenzuar në vitin 2023, për shpenzim në vitin 2024’, ku kanë ndodhur disa gabime teknike, që duhet të korrigohen, përkëtë punë kam marrë informata nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, e cila e ka zhvilluar një komunikim me përfaqësuesit e buxhetit, në kuadër të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, kemi gabim në numra të disa kode të programeve dhe në emërtimin e tyre. Ftoi Nënkryetarin e Komunës që të na jap sqarime.

Nënkryetari i Komunës: Unë tani dua të sqaroi para juve se këtu kemi të bëjmë me një gabim teknik në numër të një projekti kapital, te tejkalimi I buxhetit të komunës nga të hyrat vetjake të vitit 2023, si dhe ndryshimin e emërtimeve te disa nën kode të programeve, nuk duhet të shënohet emri Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, por shërbimet kulturore, në drejtorinë tjetër duhet të jetë shërbimet sociale. Ndërsa te çështja e dytë te bartja e buxhetit të pa shpenzuar, kemi vetëm një promutacion - ndërrim të kodit ekonomik ka qenë 49135 gabim, duhet të jetë 49315, fjala është për projektin e ‘Dixhitalizimit të Sallës së Kuvendit të Komunës’, këtu kërkesa e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës ka qenë, që secili ndryshim duhet të bëhet me vendim të Kuvendit të Komunës. Tani dua të jap edhe një sqarim që e definon neni 9, paragrafi 6, i ligjit për ndarjet buxhetore, ku projeksionet buxhetore janë aprovuar njëherë, në Kuvendin e Kosovës, ato nuk ndërrohen dhe bilancet e pa shpenzuara të buxhetit barten për shpenzim nga viti paraprak, prej të hyrave vetjake, sepse këtë e thotë ligji, pa vendim, por ne do ta marrim këtu një vendim, ta kemi vendimin, pastaj të njëjtin nëse na kërkohet e dërgojmë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve. Vetë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve na kanë thënë, se pas realizimit të rritjes së buxhetit nga të hyrat vetjake të vitit 2023, bartja e buxhetit të pa shpenzuar, do të realizohet në mënyrë automatike, sipas programeve dhe nën programeve buxhetore dhe destinimit të tyre për shpenzime. Ne tani kërkojmë që t'i marrim dy vendime të ndara, shpresojmë që nuk do të na vonohet bartja e buxhetit sikur vitin e kaluar, do të bëhet sa më shpejtë bartja e buxhetit të pa shpenzuar, që është shumë i nevojshëm përzbatim në projektet kapitale, që i kemi si mjete financiare të kontraktuara.

Laureat Gojnovci: Tani sqarimet u dhanë nga përfaqësuesi i Ekzekutivit të Komunës, në këtë rast Nënkryetari i Komunës, kemi të bëjmë vetëm me një gabim teknik, që duhet të korrigohet në vendimin përritjen e buxhetit të komunës nga të hyrat vetjake për vitin 2023, andaj në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim propozimin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, për ndryshimet e kërkuar në këto dy vendime, sipas

përshkrimit të detajizuar për përmirësimin e tyre, në kode ekonomike dhe kodet e nën programeve buxhetore.

Durim Hajra: Nga materiali shihet se këtu nuk kemi të bëjmë me një gabim teknik, sepse ju keni komunikuar dy herë me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, neve po na përcjellin gabimet në këto vendime. Unë dua të jem i sinqertë me Nënkyryetarin e Komunës, por gjatë rrugës është konstatuar, se këtu kemi të bëjmë me një vendim tjetër. Ne kërkojmë që ta informohemi për formën e komunikimit me Ministrinë e Financave deri në fund të mbledhje, ne duhet ta dijm cili ka qenë niveli i komunikimit, ndërmjet zyrtarëve, sepse ne nuk kemi asnje shkresë apo email zyrtar të komunikimit me Ministrinë e Financave.

Shpend Bardiqi: Tani këtu ne e kemi planifikimin e bartjes së të hyrave vetjake dhe planifikimin e buxhetit nga rritja e të hyrave vetjake, të cilat janë pjesë e këtij vendimi, që ne e dojmë shumë si kategori, sepse kemi mundësi reale të tejkalojmë grumbullimin e të hyrave vetjake, të cilat duhet të shpenzohen aty ku ka nevojë, por kjo nuk ndodh në komunën tonë.

Nënkyryetari i Komunës: Mjetet financiare nga të hyrat vetjake, mund të barten në secilën kategori ekonomike, me përjashtim të pagave dhe mëditjeve. Unë nuk dua të dal me një qasje para juve, por ne kemi dërguar shtatë qind shkresa të ndryshme, por nuk e kemi asnje përgjigje nga institucionet qendrore po thuaj se, nga kërkesat tona do ta bëjmë një libër, komunikimi ka qenë në nivele të ndryshme, me zyrtar me drejtore të departamenteve, Agjensitë e Ministrive dhe Qeverisë, me sekretar apo edhe ministra të Qeverisë së Kosovës, dihet si funksionon mënyra e komunikimit zyrtar. Komunikimi për bartjen ka qenë edhe me telefon, ne shpresojmë që bartja e buxhetit do të bëhet sa më shpejtë, në mënyrën ashtu sikur e miratojmë ne në Kuvendin e Komunës, apo sipas planifikimit të tij sipas dispozitave të ‘Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive’. Te vendimi për të hyrat vetjake ne kemi të bëjmë vetëm me një korrigjim që e kemi cekur më lartë, vendimet e komunave janë autonome, unë jam ushtar i qeverisjes lokale, në komunikim me Ministrinë e Financave. Lidhur me kërkesën e anëtarit të Kuvendit të Komunës, vendimi për subvencione dhe projektet buxhetore, janë vendime që janë shndërruar në ligje nga Kuvendi i Kosovës. Në rastin e studentëve serb janë tetë raste, ata janë student të Kosovës, por me dokumentacion të Republikës së Serbisë, kjo punë është e rregulluar me ligjet në nivel vendi, ne për këto raste kemi këruar sqarime edhe nga Ministria e Arsimit, ne lidhur me qasjen në dokumente zyrtare i kemi marrë 37,000.00€, dënimë nga Agjensia për Informim dhe Privatësi, unë ju inkurajoi juve që këto raste t'i dërgoni atje, nëse nuk merrni qasje nga komuna, sepse mjetet financiare prapë shkojnë në buxhetin e Kosovës, nuk humbin.

Shpend Bardiqi: Unë pajtohem me mendimin e Nënkyrytarit të komunës, se komuna duhet të jetë autonome në vendimet e saj, ju po theksoni se mjetet financiare nga bartja e buxhetit janë të kontraktuara, për çerdhe, shkolla, atëherë pse asnjeherë nuk e keni ndërtuar shkollën në lagjen e Nakaradës, aty ku e keni blerë pronën komunale, e cila është e uzurpuar, pse po paragjykon për procesin e bartjes së buxhetit. Qeveria është e ndarë nga pjesa civile e pushtetit, ku bënë pjesë edhe Sekretari Permanent dhe zyrtarët. Këtu në Kuvendin e Komunës nuk vjen asnjeherë Kryetari i Komunës, për të sqaruar projektet publike, premtimet e tij për investime në fushatën zgjedhore, realizimin apo mos realizimin e tyre, ne nuk kemi informacion për këto projekte publike.

Nënkyryetari i Komunës: Këtu komunikimi zyrtar me Qeverinë e Kosovës, nënkupton komunikimin me z. Albin Kurti si Kryeministër, në këtë raste komunikimi duhet të bëhet nga Kryetari i Komunës, në komunikim duhet të respektohet hierarkia e institucioneve, ky komunikim

është bërë në nivele të ndryshme. Në nivelin qendror kur hiqen shpenzimet e komunave, niveli i shpenzimeve nga Qeveria e Kosovës, është 27%, te ne vitin e kaluar buxheti nga të hyrat vetjake, na është bartur vetëm në muajin e tetë, por ne kemi arritur që deri në fund të vitit të shpenzojmë rrëth katër milion euro dhe të kemi projekte të kontraktuara me buxhet në vlerën e për afërt prej rrëth katër milion euro.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për ‘Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 27, të datës 04.03.2024 për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, pjesëmarrës në votim, e aprovuan ‘Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 27, të datës 04.03.2024 për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës’ dhe mori:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 27, të datës 04.03.2024 për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 389,203.44€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore: paga e shtesa, subvencione e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve.

Tani pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për ‘Propozimin për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 dhe 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 5,928,930.44€, sipas propozimit dhe përshkrimit të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 423, të datës 25.03.2024 me ndryshime, për kategoritë ekonomike të shpenzimeve, nga bartja e buxhetit në vitin 2024’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, pjesëmarrës në votim, e aprovuan ‘Propozimin për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 dhe 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 5,928,930.44€, sipas propozimit dhe përshkrimit të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 423, të datës 25.03.2024 me ndryshime, për kategoritë ekonomike të shpenzimeve, nga bartja e buxhetit në vitin 2024’ dhe mori:

V E N D I M

Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 dhe 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 5,928,930.44€, sipas propozimit dhe përshkrimit të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 423, të datës 25.03.2024 me ndryshime, për kategoritë ekonomike të shpenzimeve.

Pika e tretë (3) - Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës pas sqarimeve, e qiti në votim për shfuqizim Vendimin Nr. 31, të datës 06.02.2023, për aprovimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim, e aprovuan ‘Propozimin për shfuqizim Vendimin Nr. 31, të datës 06.02.2023, për aprovimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’ dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e aprovimit në parim të vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023 të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej 30 minutave.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtimin e parë ‘Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, ftoi Kryesuesin e Grupit Punues z. Ejup Qyqalla që të na jap sqarime.

Ejup Qyqalla - Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Mbeturinat duhet të trajtohen në disa cikle të tyre, grumbullim në burim, për riciklim dhe ripërdorim të tyre, këtu hyn edhe mbledhja në burim e tyre, ne e kemi shërbimin derë me derë në fshatra, ku funksionon shumë mirë, në qytet i kemi kontejnerët e mëdhenj. Në trajtimin e mbeturinave na ka ndihmuar shumë edhe GIZ-i Gjerman, ambienti i pastër ndikon edhe në ruajtjen e shëndetit publikë. Grupi Punues ka propozuar këto ndryshime, mbështetur në kërkesën e Komisionit Komunal të Aksionarëve të komunës tonë në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave ‘Pastrimi’, në këtë fushë ka edhe sfida, të cilat ne synojmë t'i rregullojmë me marrëveshje për ndarje në burim dhe riciklim të mbeturinave. Tani kemi rritje të çmimit të naftës, rritje të çmimit për dërgimin e mbeturinave në deponi, ku është rritur tarifa për tonë nga Qeveria e Kosovës, deri tani tarifa mujore për grumbullimin e mbeturinave ka qenë 4.70€, meqë komuna jonë dhe komuna e Prishtinës dallojnë nga komunat tjera, propozimi është që tarifat për amvisëritë të rritet në 6.20€. ne e kemi edhe një problem tjeter që duhet ta caktojmë, një lokacion për vendosjen e mbeturinave inerte, Nga raporti finanziarë shihet se ‘Njësia e Pastrimit e Fushë-Kosovës’, ka grumbullim prej: 90%, por këto mjete financiare barten dhe administrohen nga niveli rajonal i Kompanisë, kemi tarifa të ndryshme nëpër komuna, kemi rritje të saj në 6.20€, në një komunë tjeter tarifa është rritur në 6.50€, rritja shkon edhe në deri 6.80€ në Komunën e Deçanit, por ne rritjen propozojmë ta bëjmë njësoi me Komunat në Rajonin e Prishtinës.

Laureat Gojnovci: Pas marrjes së sqarimeve, ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi përkrahur për aprovim, kërkesën për rritjen e tarifave për amvisëritë, por edhe

propozimet tjera për subjekte afariste, banim jo rezidentë dhe institucione. Rritja e tarifave tani është një domosdoshmëri, sepse kemi rritje të çmimeve të naftës, rritje të kostos financiare për dërgimin e mbeturinave në deponi, ku është rritur çmimi tre euro për një tonë, kemi inflacion, mekanizmi i punës është i vjetërsuar, andaj kërkohen investime të reja në kamionë dhe mjete të punës, punëtorët i kanë pagat e ulëta. Njësia e Fushë-Kosovës, i dërgon nëntëmbëdhjetë tonë në vitë në KMDK-në, në mënyrë që të kemi një efikasitet në punë dhe shërbime më të mira, nevojitet të bëhet kjo rritje e tarifës së mbeturinave për amvisëritë, por edhe për kategoritë tjera, që grumbullimin e mbeturinave bëhet në bazë të vëllimit të tyre. Secili këtu për këto tarifa mund ta ketë opinionin e vetë, këtu për herë të parë hyn edhe kategoritë e reja, sikur është tarifa për banorët jo rezident në shumë prej: 17.80€, mbështetur në të gjitha këto fakte, unë në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrah për aprovim në parim për diskutim publikë ‘Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

Habib Mekolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu janë tri arsyet për rritjen e tarifave ripërdorimi, riciklimi I mbeturinave, që ndikon në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Përmua organ qendoror që duhet të merret me menaxhimin e mbeturinave është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, për ta pasur ne një qytet të pastër, nevojitet një angazhim më i madh, me përkrahje nga komuna, një angazhim për vendosjen e kontejnerëve në vendet e duhura, disa prej tyre janë në trotuare, largohen nga njerëz të caktuar, prej vendeve të caktuara nga organet përkatëse komunale. Lidhur me këtë rregullore dhe tarifat e reja është qëndrim i Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, që për një kategori nuk duhet të rriten tarifat, për qytetarët, ne pajtohem që të rriten tarifat për subjektet biznesore, që gjenerojnë shumë mbeturina, por kjo rritje nuk duhet të bëhet për qytetarët e komunës tonë.

Fisnik Sllamniku: Çështja e rritjes së tarifave për kompaninë që e bënë grumbullimin e mbeturinave, është e nevojshme, sepse çmimet janë rritur, unë dua të flas këtu përfshatrat, ku shërbimi është shumë i mirë, ku secila familje e ka kontejnerin personal, kjo është një zgjidhje e mirë, tarifat janë të arsyeshme, sepse shërbimi është i duhur, andaj kjo rritje e propozuar nuk është e lartë, sepse tani kemi inflacion, po ashtu edhe kostoja financiare për grumbullimin e tyre tani është rritur. Ne i rekomandojmë Kompanisë Rajonale të Mbeturinave ‘Pastrimi’, që të merret me mirëqenien e punëtorëve, t’iu blihen atyre dorëza të reja, veshje adekuate për këtë punë, të ju rriten pagat, ne jemi shumë më mirë me këto shërbime, se disa komuna tjera, sidomos nëpër fshatra gjendja e ambientit është shumë e mirë, meqë grumbullimi i mbeturinave është i rregullt.

Hasan Ismajli: Unë dua të kem disa informacione nga aksionarët e komunës në këtë kompani, që janë votuar në Kuvendin e Komunës z. Habib Mekolli dhe z. Laureat Gojnovci, tani ne materialin e kompanisë e kemi marrë vonë, nuk kemi pasur kohë as ta lexojmë, ne kërkojmë një raport apo përshkrim për hyrjet dhe daljet, buxhetin e kompanisë, sepse e dijm që grumbullimi i tarifave për mbeturina në komunën tonë është 90%. Ne në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës i kemi liruar nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike 2750 biznese, ku dikujt mund t’i jenë falur vetëm 100.00€, por nuk është e arsyeshme t’i falen taksat komunale, dikujt që ka qarkullim ekonomik mbi dy milion euro, ndërsa qytetarëve u rriten tarifat, kjo mënyrë e qasjes nuk është e drejtë. Te lirimi i taksave komunale për biznese ku janë 2750 biznese, ne tarifat e pastrimit janë vetëm 1300 prej tyre, këtu nuk hyn amvisëritë, në kuadër të bizneseve janë 136 biznese të mëdha që gjenerojnë shumë mbeturina, disa prej tyre mbeturinat i hedhin në kontejnerët e ‘Viva

Freshit', mbeturinat hidhen edhe në trotuare jashtë kontejnerëve, sepse Inspektorati në komunën tonë nuk funksionon në teren, njësoi ndodh edhe hedhja e mbeturinave nga qebaptoret te rrethi, të cilët i bijnë mbeturinat shpesh herë edhe para banesave ku banoi unë. Tani ne e kuptojmë që kjo 'Projekt-Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', është në leximin e parë. Kompanitë biznesore punojnë me fitim, andaj edhe duhet të paguajnë taksa për grumbullimin e mbeturinave, tarifat për qytetarët nuk duhet të rriten kur kompania ka mbetje të buxhetit, i cili shkon në qendër dhe përdoret në komuna tjera, ndërsa nuk blihen pajisje të reja për Njësinë e komunës tonë, për disa kategori të popullatës shuma prej: 6.20€, ndoshta nuk është e lartë, por kjo është shumë e lartë për penzionerët, por ju këto rregullore do ta votoni sepse e keni edhe përkrahjen e partnerëve strategjik, që i mbështesni me mjete financiare të buxhetit, edhe me dokumentacion të Serbisë, e me vendbanim të tyre në Novi Sad.

Shpend Bardiqi: Në komunën tonë ne kemi edhe biznese të mëdha, me mbi pesëmbëdhjetë mijë metra katror, atyre ju hiqen taksat e ushtrimit të veprimtarisë biznesore, ndërsa qytetarëve u rriten tarifat për 1.50€, për një pjesë të popullatës mjetet financiare janë problem, por ju nuk i shihni me këtë anë, sepse ju punoni me biznese, nga të cilat kërkon pastaj përkrahje në fushatën zgjedhore. Ne nuk e morëm një sqarim për kategoritë e rrithes së tarifat, të vendosura në tabelën e tarifave sipas kategorive, ku këto shuma duhet të jenë në raste të caktuara sipas vëllimit të tyre, ne kemi betonjerka edhe në zonën rurale, që paguan vetëm 8.40€, kemi restaurante në fshatra që kanë shumë fitim dhe krijojnë shumë mbeturina dhe ata duhet të paguajnë vetëm 15.50€, 'u sqarua se kjo shumë vlen për secilën zbranje të kontejnerëve. Për mbeturinat e vëllimshme duhet, për të pasur një ambient të gjelbërtë, duhet të mirren shembull vendet evropiane, ku paguajnë për mbeturina nga 50.00€ deri në 200.00€, pastaj ka raste kur më lirë kushton falja e mobiljeve, se sa hedhja e tyre në hekurishte të caktuara.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë këtu dua ta paraqes gjendjen e komuniteteve tona, pajtohem që për pastërtinë duhet të shtrejtohen pak tarifat, por unë e kam një vërejtje për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', unë i kam edhe disa video të cilat do t'i jap privatisht, juve i nderuari z. Jetmir Berisha, pas një diskutimi lidhur me këtë çështje, z. Bashkim Krasniqi deklaroi publikisht se nuk do ta votoi aprovin e kësaj rregullore.

Hasan Ismajli: Unë e kam regjistrin e pagesave të mbeturinave, ku një biznes për një zbranje paguan 42.00€, dua ta kem edhe një sqarim për veshë mbathjet dhe mbeturinat tjera, që lihen ditën e marte pas përfundimit të tregut ditor, të cilat grumbullohen pastaj nga punëtorët fizik me projekt të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për kalimin në procedurën e diskutimit publikë të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katërbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim, e aprovanë parim për kalimin në procedurën e diskutimit publikë të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim të ‘Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’ dhe procedimin e saj për diskutim publik.
2. Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parashev mënyrën e menaxhimit, ndarjen e mbeturinave në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e pestë (5) - Propozim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim në bujqësi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin e ekonomive familjare dhe fermerëve të komunës’, ftoi Drejtoreshën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që të na jap sqarime.

Drejtoresha e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani ju e keni në shqyrtim ‘Propozimin për përkrahjen e ekonomive familjare dhe fermerëve me ndarjen e subvencioneve në bujqësi për vitin 2024’, ku propozim është bërë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2024, financimi do të bëhet nga të hyrat vetjake, andaj ne si Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, kemi propozuar që të hiqet participimi i fermerëve.

Shpend Bardiqi: Është shumë e qartë se është herët, mirëpo ne tani të ju pyesim juve, meqë tani e keni marrë detyrën, pas aprovimit të buxhetit, shuma është tani e ulët për subvencione në bujqësi, por është fakt se në të kaluarën moto kultivatorët e dhënë nga komuna, kanë qenë të vendosur në terasa të banesave për shitje në lagjen e ‘Dardanisë’. Ne kemi kërkuar më herët që të ndahen mjete financiare prej 2 centëve për një litër qumësht për fermerët e komunës tonë, na është thënë se kjo nuk është në kompetencën e komunës, më vonë e kemi verifikuar se kjo mund të bëhet dhe është bërë nga shumë komuna të vendit tonë, andaj ne kërkojmë që të përkrahen këta fermer. Subvencionet e ndara nga komuna duhet të mbikëqyrë dñe inspektohen dhe neve të na dorëzohet një raport, për këtë punë. Tani ne po ndajmë 120,000.00€ dhe e kemi vetëm një faqe A 4, me dhjetë rreshta, andaj me këtë qasje nuk mund të kërkohet një standard i lartë në Komunën e Fushë-Kosovës, sa i përket zhvillimit të bujqësisë, sepse këto subvencione ndahen në mënyrë klienteliste për të blerë votën, andaj zhvillim të bujqësisë në këtë formë, nuk do të ketë as deri në fund të këtij mandati zgjedhor.

Vlonjat Hasani: Nëse dikush është ndier i ofenduar nga diskutimi im ynë kërkoi falje publikisht, tani dua t'i kthehen rendit të ditës, unë kam shpresuar që me ndërrimin e drejtorit, do të ndërron edhe qasja ne përkrahjen e bujqësisë, e kuptojmë se duhet të japim një kohe juve si Drejtoreshë e re, por nga propozimi po shihet se kjo punë do të vazhdon njëjtë, ka pasur raste në të kaluarën kur dikush ka qenë përfitues pesë herë, e dikush asnjëherë, nëse nuk je me Lidhjen Demokratike të Kosovës nuk mund të përfiton, sepse ndarja e subvencioneve është bërë për familjet e mëdha, tani është mirë që edhe participimi i zvogëluar vitin e kaluar në 3%, do të hiqet krejtë, por ndarja e subvencioneve e kërkon edhe një mbikëqyrje nga ana e komunës, sepse ka pasur raste kur moto kultivatorët janë shitura, serrat u janë dhënë edhe njerëzve që nuk i kanë shfrytëzuar për mbjelljen e perimeve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nuk është korrekte që unë të quhem këtu i pa sinqertë, kur secili këtu e ka pasur hapësirën dhe kohën e nevojshme për dhëni e qëndrimit të tij, për secilën çështje.

Krenar Dumani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e përkrahim iniciativën e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për përkrahjen e fermerëve, mendimi ynë është se fermerët duhet të përkrahen edhe me dhëni e plehat azotikë, të jepet nafta me çmim më të ulët për 50%, për fermerët sikur në vendet tjera, a jo ajo të shitet njëjtë sikur për makina. Qëndrimi se janë përkrahuar vetëm njerëzit, që janë me Lidhjen Demokratike të Kosovës, është i pavërtetë, sepse përfitues janë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, pa asnje dallim partiakë.

Hasan Ismajli: Unë dua ta paraqes këtu një pyetje, dua të dijë Komisioni për ndarjen e subvencioneve në bujqësi, a kanë kritere të përshkruara paraprakisht, sepse subvencionet e dhëna nga komuna janë vendosur, në të kaluarën në terasa të banesave për shitje, ndërsa në fshatra në serra janë vendosur drunjët. Tani ne po e shohim se shuma e mjeteve financiare është e vogël, vetëm 120,000.00€, tani edhe participimi do të jetë zero, në të kaluarën ka qenë edhe 20%, vetëm vitin e kaluar me vendim të Kuvendit të Komunës, është ulur në 3%, sepse është thënë, se kjo punë duhet të jetë kështu, për arsyet e kodit të bashkëfinancimit, tani kjo punë ju e keni theksuar se lejohet nga aspekti financier, por na nuk kemi sqarime.

Durim Hajra: Ne në parim jemi që të lehtësohet puna për fermerë dhe ata të përkrahen nga komuna dhe shteti, tani po e hiqni edhe participimin, sepse në të kaluarën këtë nuk e keni bërë, për arsyet që ju i keni dhënë, ne kërkojmë të na jepen sqarime për këtë punë, pse kjo nuk është bërë viteve të kaluara.

Drejtori për Infrastrukturë: Bashkëfinancimi ka qenë sepse projektet në bujqësi janë realizuar edhe nga participimi i qytetarëve, me një pjesë të mjeteve financiare të grumbulluara nga viti paraprakë, tani subvencionet do të ndahen vetëm nga të hyrat vetjake të komunës, nuk ka mjete financiare nga kodi i bashkëfinancimit, andaj mund ta heqim në aspektin formal, edhe participimin e fermerëve.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin e ekonomive familjare dhe fermerëve të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, pa participimin e fermerëve’

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, asnje votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim, e aprovuan ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin e ekonomive familjare dhe fermerëve të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, pa participimin e fermerëve’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve për bujqësi në shumë prej: 120,000.00€, nga të hyrat vetanake për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2024 si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, nga buxheti i komunës destinojen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Serrave’;
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, nga buxheti i komunës destinojen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Motokultivatorëve’;

- 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 50,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Miksera’ dhe
- 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 30,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Mekanizmit bujqësor’.
2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë prej subvencioneve, nga paragrafi 1, nën - paragrafët prej 1.1 e deri tek nën - paragrafi 1.4, të paragrafit një të këtij vendimit, bëhet pa participim nga fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për formimin e Komisionit për Zëvendës Drejtor të shkollës në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për formimin e Komisionit për Zëvendës Drejtor të shkollës në Fushë-Kosovë’, ftoi Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Para juve e keni propozimin për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Zëvendës drejtorit të shkollës ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë, sepse znj. Remzije Bogujevci shkon në pension, kjo punë është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Arsimit, ku në komision parashihet të jetë një përfaqësues i Drejtorisë Komunale të Arsimit, një drejtor i shkollës me përvojë tre vjeçare, zakonisht ne në komision e kemi caktuar drejtorin e shkollës, ku bëhet përzgjedhja, ju ftoi që ta përkrahni këtë propozim, për juve kjo procedurë është e njobur nga dy vitet e kaluara.

Hasan Ismajli: Lidhur me këtë punë unë e kam pasur një përplasje me vendasin tim Ish/Drejtorin e Arsimit z. Samir Shahini, sepse e kam kërkuar një Svi-në, të anëtarëve të Komisionit, këta emra janë caktuar nga ju dhe Kryetari i Komunës dhe unë disa prej tyre nuk i njoh.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo punë është e paraparë me Udhëzim Administrativ dhe duhet të përkrahet edhe nga Kuvendi i Komunës, si procedurë.

Hasan ismajli: Unë ta zëmë personin me numër rendor pesë nuk e njoh fare, andaj e kërkojmë Svi-në e tyre.

Fisnik Sllamniku: Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrah për aprovim ‘Propozimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit për formimin e këtij Komisioni’, sepse kjo çështje është e rregulluar më Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Arsimit, ku anëtari i Komisionit që është drejtor duhet të ketë së paku tre vite përvojë pune, ju e njohni z. Esad Simnica, ai e plotëson këtë kusht, e njohni edhe anëtaren e Drejtorisë Komunale të Arsimit znj. Elmije Grajçevci Zymberi, ka përvojë mbi njëzet vjeçare në arsim, një përfaqësues është nga Ministria e Arsimit, një përfaqësues në cilësinë e vëzhguesit është nga Këshilli i Prindërve dhe një përfaqësues e cakton shkolla.

Vlonjat Hasani: Tani disa shqetësime për përbërjen e Komisionit u ngriten nga kolegu z. Hasan ismajli, i cili e kërkoi Svi-në e tyre, pse ne atë nuk e kemi, unë kërkoi që një trup nga Kuvendi i Komunës të lejohet në cilësinë e vëzhgimit të procesit, pa të drejtë ndërhyrje, sepse këtë punë e definon qartë edhe udhëzimi administrativ, por nuk përjashtohet mundësia e monitorimit nga ana e Kuvendit të Komunës, këtë punë ne e kemi kërkuar edhe në të kaluarën, por nuk kemi hasur në përkrahjen tuaj.

Drejtori për Arsim: Formimi i këtij Komisioni parashihet me Udhëzimin Administrativ, znj. Elmije Zymberi ka përvojë pune 23 vjet, Esad Simnica është drejtor në shkollën ‘Selman Riza’ me

përvojë në arsim, Gazmend Bekolli është përfaqësues i prindërve, andaj mos paragjykon pa të drejtë për përvojën e njerëzve të caktuar.

Vlonjat Hasani: Nuk e kontestojme Svi-në e tyre, por të anëtarëve tjerë të Komisionit të cilët nuk i njohim.

Hasan Ismajli: Arsyja pse ne e kërkojmë këtë është, se në konkursin për Inspektor të Tregut kanë aplikuar 36 aplikantë, kushtet për intervistim i kanë plotësuar vetëm 3 aplikantë, ndërsa në intervistë ka shkuar vetëm një, personi që është marrë në punë, si zakonisht, andaj ne i kemi dyshimet tona për ecurinë e procesit dhe kemi të drejtë të kërkojmë një Komision për monitorimin e procesit të përzgjedhjes së Zëvendës Drejtorit të Shkollës.

Nënkryetari i Komunës: Ne jemi të obliguar të punojmë vetëm në bazë të legjislacionit përfushëm e arsimit, ky Komision parashihet me Udhëzim Administrativ të caktohet nga Kuvendi i Komunës, në aspektin formal dhe anëtarët i propozuar e kanë përvojën e duhur për punë në këtë komision.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në ‘Propozimin përfundimini e Komisionit për monitorimin e punës së konkursit publik përzgjedhjen e Zëvendës Drejtorit të Shkollës, nga anëtarët e Kuvendit të Komunës’.

U votua me: pesë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave nuk e aprovon ‘Propozimin përfundimini e Komisionit për monitorimin e punës së konkursit publik përzgjedhjen e Zëvendës Drejtorit të Shkollës, nga anëtarët e Kuvendit të Komunës’.

Pas sqarimeve shtesë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në ‘Propozimin përfundimini e Komisionit përzgjedhjen e Zëvendës Drejtorit të Shkollës ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë’ sipas përbërjes së propozuar nga Drejtoria e Arsimit.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim, e aprovuan ‘Propozimin përfundimini e Komisionit përzgjedhjen e Zëvendës Drejtorit të Shkollës ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë’ sipas përbërjes së propozuar nga Drejtoria e Arsimit dhe mori:

V E N D I M

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët ‘Selman Riza’, në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Për konkursin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët ‘Selman Riza’, në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 2.1 Elmije Grajçevci Zymberi - Kryetare e Komisionit Shefe e Drejtorisë së Arsimit;
 - 2.2 Esad Simnica - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët ‘Selman Riza’, në Komunën e Fushë-Kosovës;
 - 2.3 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit.
- 2.4 Gazmend Bekolli - në cilësinë e vëzhguesit dhe
- 2.5 Indire Sahiti - në cilësinë e vëzhguesit.

Pika e shtatë (7) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 07, të datës 07.02.2024 për lejimin e mjeteve financiare përpunëtorët arsimorë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në mbledhjen e kaluar ju kam informuar për ‘Kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Nr. 07, të datës 07.02.2024 për lejimin e mjeteve financiare për punëtorët arsimorë’. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Ky vendim ka marrë dy muaj kohë, ne ju kemi paralajmëruar se ligji është i njëjtë dhe marrja e vendimit në këtë formë, mund të kthehet në rishqyrtim nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, po me insistimin e juaj janë humbur dy muaj dhe ja ku jemi tani, vendimi i marrë në mbledhjen e muajit janar 2024 për punëtorët arsimorë, nuk mund të zbatohet, por ju po veproni me inate politike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Drejtori për Arsim: Vendimi i kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, thekson se pagesa e mësimdhënësve që nuk janë në listën e pagave, mund të bëhet vetëm nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, ndërsa para katër muajve na është mundësuar pagesa nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, kjo qasje nuk është në rregull, neve deri në muajin janar 2024, na janë shtuar 82 nxënës të ri, për të cilët duhen 6 norma, kjo për neve tani e paraqet një sfidë, sepse nuk mund të zbatojmë vendimin për lejimin e shumës së mjeteve financiare prej: 266,000.00€, tani kjo punë do të zvarritet, sepse mësimdhënësit prapë do t’i marrin pagat e mbetuar përmes procedurave gjyqësore dhe nëpërmjet përbartuesve privat, por kostoja financiare për buxhetin e komunës do të rritet, këtu hyn edhe pagesa për avokatët, ne kemi tentuar që ta ulim këtë kosto financiare. Ne për këtë çështje u kemi dërguar shkresa zyrtare: Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave, kemi kërkuar takime, për ne kjo është një sfidë shumë serioze, sepse vetëm për shkollën e re që është në ndërtim e sipër në muajin shtator na duhen edhe 40 norma të reja. Komuna jonë ka tentuar ta bënë një zgjidhje përmes votimit të lejimit të buxhetit shtesë nga kategoritë tjera ekonomike në Kuvendin e Komunës, por përgjegjëja e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, tani është se këtë mund ta bëni vetëm nga kategoria ekonomike e pagave dhe meditjeve, andaj unë tani e shtroi këtu një çështje për diskutim, çka tani, si të veprojmë tani kur mësuesit i kemi pa paga, këtu hynë, edhe ato mësimdhënëse që shkojnë në pushime të lehonisë.

Durim Hajra: Ju po mundoheni të jeni bindës në fjalimin tuaj, po del se fajin e ka niveli qendor, ju po veproni me një qasje të gabuar. Ky problem nuk është tani, na ka përcjellur me vite, problemi qëndron te mos kontrollimi i ndërtimeve dhe përcjellja e tyre me infrastrukturë sociale.

Drejtori për Arsim: Unë shkresat tona të dërguara në Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Financave, që nga viti 2012, ua kam dërguar juve në email adresë zyrtare.

Durim Hajra: Unë këto shkresa nuk i kam marrë, do ta shikoi prapë emailin zyrtar nëse ka ndonjë problem dhe do ta verifikoi.

Hasan Ismajli: Tani këtu faji është i juaji, unë i kam votuar zëvendësimet, sepse nxënësit mësuesin duhet ta kenë në klasë, problemin me zëvendësime e kanë edhe komunitat tjetra të Kosovës, dikun ka zëvendësime më shumë e dikun më pak, këtë problem duhet ta zgjidhë në nivel vendi Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit. Tani mësimdhënësit pa paga, kjo punë është për keqardhje, sepse ata në fund të muajit nuk marrin pagë, çështja e mësimdhënësve nuk u zgjidh as me lejimin e 156 normave në arsim nga Ish/Drejtori i Arsimit z. Samir Shahini, i cili ka thënë këtu në foltoren e Kuvendit të Komunës, me mburrje se ka arritur të siguroi këto norma për buxhetin e vitit 2023, ai atëherë është kundërshtuar nga Ish/Nënkyetari i Komunës z. Fadil Krasniqi, se kjo nuk do të ndodh, por normat u siguruan, por disa prej tyre nga ana e juaj u barten në shëndetësi. Tani as këto norma, as njëzet e katër norma tjetra të lejuara për pagesa në muajin gusht 2023, nuk e kanë zgjidhur çështjen, sepse ju disa norma të arsimit, vetë i keni bartur në shëndetësi, andaj për këtë ne e kërkojmë një sqarim shtesë nga Drejtori i

Infrastrukturës, që e dinë këtë punë, apo nga Drejtori për Arsim, në vazhdim u sqarua se në arsim kanë mbetur vetëm 146 norma.

Nënkyetari i Komunës: Unë këtu po u kërkoi falje në emër të Ekzekutivit të Komunës, por ju në diskutimet e juaja po ja huqni krejt, edhe z. Durim Hajra, por edhe ju të tjerët, këtu nuk është faji as i drejtorit, as i zyrtarëve, sepse ata punojnë sipas legjislacionit në fuqi. Qeveria e Kosovës i ndan pagat për arsimtarë dhe mjekë sipas formulave buxhetore, që ju i dini, tanë unë dua të them se këtë problem, nuk e kanë zgjidhur as Qeveria ‘Hoti’, as Qeveria ‘Haradinaj’, as Qevria ‘Thaçi’, po as kjo e tanishmja, me përjashtim të një pune të mirë sikur është lejimi i normave në buxhetin e viti 2023. Ne jemi të obliguar që nxënësve t’ia dërgojmë mësuesin në klasë, madje ne vendimin e fundit kemi kërkuar që kjo çështje, të mbulohet në aspektin financiarë, qoftë nga kategoria ekonomike e mallrave e shërbimeve ose e subvencioneve e transfereve, por rekomandimi i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, është që kjo punë mund të kryhet vetëm nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve. Ne e kemi sistemin ‘Smia’, ku janë të evidentuara lista e numërit të nxënësve, këtë punë e dijnë mirë edhe Ministria e Arsimit, e cila kërkon norma nga Ministria e Financave, por ata në bazë të formulës ligjore për ndarjen e buxhetit, nuk e aprovojnë kërkeshën përritje të normave, aq sa i kemi kërkuar, ne sipas nevojave përfunksionimin normal në arsim. Kryetari i Komunës, në mungesë të zgjidhjes së këtij problemi nga institucionet qendrore, që veprojnë konform formulave të ndarjeve buxhetore, ka propozuar zgjidhjen e këtyre problemeve nëpërmjet vendimeve të Kuvendit të Komunës, sepse nuk kemi patur zgjidhje tjera, nuk kemi mundur t’i lëjmë fëmijët në rrugë, zgjidhja e këtij problemi për Komunat e Kosovës, është punë e Qeverisë së Kosovës. Ne kur propozojmë të ndajmë mjete financiare nga të hyrat vetjake të komunës tonë, i dëmtojmë projektet publike, kjo është një paradoks në vetë vete, sepse me marrjen e pagave të pa paguara nga ana e mësuesve, nëpërmjet procedurave gjyqjësore dhe përmbaruesve privat, e dëmton edhe më shumë buxhetin e komunës, këto procedura shkojnë më së shumti në favorin e tyre, si profesionistë, sepse ata realizojnë fitime të mira. Ne jashtë listës së pagave i kemi dikun rreth pesëdhjetë mësues, andaj unë ju kërkoi juve që secili që ka autoritet dhe lidhje, që mund të ndikon në zgjidhjen e kësaj çështje, ta ushtron ndikimin e tij të lidhjeve të komunikimit shoqëror apo institucional, e rëndësishme, është që të vijmë deri te një zgjidhje, që do të ndikonte në ruajtjen e buxhetit të komunës. Ne jemi në proces të ndërtimit të një shkolle në rrugën ‘Agim Elmazi’ në Fushë-Kosovë, të cilën shpresojmë të kemi të gatshme në muajin shtator, një çerdhe publike është në ndërtim nga Ministria e Arsimit, po ashtu planifikojmë ta ndërtojmë edhe një çerdhe tjeter nga buxheti i komunës, sikur se edhe një shkollë nga buxheti i komunës, e kemi të planifikuar, një shkollë na është premtuar se do të ndërtohet dhe financohet nga Ministria e Arsimit, me ndërtimin e këtyre objekteve shkollorë, do ta zgjidhim problemin e hapësirave shkollorë për shumë vite, por prapë do ta kemi problemin me normat në arsim deri në zgjidhjen e këtij problemi në nivel vendi, një mësues kur shkon në pushim të lehonisë, atij i ruhet vendi i punës në sistemini e pagave dhe ka pengesa administrative, sa i përket numrit të mësuesve në listën e pagave, nuk ka mundësi ligjore dhe financiare, të marrim mësuesin tjeter. Unë jam idhtar i mendimit që Shkollën e Mesme të Lartë, sidomos atë profesionale, ta zhvendosim jashtë qytetit të Fushë-Kosovës, praktika të tillë ka në vendet e zhvilluara evropiane, për të liruar hapësirat për nxënësit e Shkollave Filllore në qytetin tonë, meqë tanë jemi duke punuar në tre ndërrime dhe në disa lokacione të ndryshme të objekteve shkollorë në qytet, për arsy se rrije e numrit të nxënësve është e vazhdueshme, për shumë vite radhazi në Komunën e Fushë-Kosovës.

Hasan Ismajli: Tani i nderuari Nënkyetar i Komunës, zgjidhja e kësaj çështje nuk u realizua, as pas marrjes së 156 normave të reja, të siguruara në vitin 2022, por të realizuara në aspektin buxhetore në janar të viti 2023, ku mbeten këto norma, kah janë dërguar kjo punë e kërkon një

verifikim, sepse ju këto norma, një pjesë të tyre e keni dërguar në shëndetësi, andaj i kemi këto telashe ende në arsim, ku shpallen konkurse publike në arsim, ndërsa punëtorët e pranuar në punë, nuk ka mundësi të hyn në listën e pagave me muaj apo vite. Unë e kam edhe një vërejtje, sepse Avokatja e komunës, duhet të jetë e thirrur që ta mbron interesin e komunës, e jo të palëve jashtë saj.

Fisnik Sllamniku: Së pari ju duhet t'i dalloni normat në arsim, me normat financiare, kërkesat tona që dërgohen në Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, procedohen për miratim në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për ndarje të buxhetit, problemi këtu ekziston në nivel të vendit. Tani në nivel vendi janë rrëth 1500 norma të lira në arsim, të cilat duhet të shpërndahen drejtë nëpër Komuna të Kosovës, ka mësues për tre deri në dhjetë nxënës në shumë zona të vendit, këto norma duhet të shpërndahen për aq sa është e mundur, sa më mirë, por prapë se prapë në aspektin praktikë të funksionimit normal, ne kemi mungesë të mbulueshmërisë së normave financiare, me buxhet dhe kjo punë më së shumti e dëmton Komunën e Fushë-Kosovës, që ka migrim të madh të gjeneratare të reja, që kanë fëmijë në shkolla. Thjeshtë ne do ta kemi këtë problem deri në regjistrimin e popullsisë, ku mund të shtohen norma të reja. Në aspektin formal ne humbim shumë buxhet duke i paguar përmbaruesit, ju duhet ta kuptioni në mënyrë të arsyeshme, se Fushë-Kosova, dallon nga komunat tjera, p.sh në Komunën e Kamenicës kemi zvogëlim të numrit të nxënësve, ndërsa normat e arsimit janë atje, sipas projeksjoneve dhe formulave të ndarjes së buxhetit, ne duhet të shpresojmë se në nivel vendi do të gjendet një zgjidhje për këto çështje, por edhe për zëvendësimet për pushimet e lehonisë.

Shpend Bardiqi: Kjo pikë e rendit të ditës tani u nxeh shumë, ne pajtohemë se teprica e mësuesve, duhet të ndahet për Komunën e Fushë-Kosovës dhe Komunën e Prishtinës, por unë mendoi se këto probleme, i ka shkaktuar edhe mos komunikimi i mirë i komunës me ministritë e linjës, sepse nga kjo Qeveri e Republikës së Kosovës janë ndarë 186 norma të reja për arsim dhe shëndetësi, këtu fajin ndoshta nuk e ka drejtori z. Fatlum Berisha që e ka marrë tani detyrë, para disa muajve, jo problemi vjen para shumë viteve, sepse ndërtimi nuk është përcjellë me infrastrukturë sociale. Unë ju pyes juve, pse atëherë normat u lejuan për Ish/Drejtorin e Arsimit z. Samir Shahini, nga po kjo qeveri, ne jemi të gatshëm të ju ndihmojmë, për mësimdhënës dhe për paga aty ku mundemi, të kemi ndikim, sepse e bëjmë një zgjidhje të drejtë përfëmijët e komunës tonë.

Drejtori për Infrastrukturë: Pëershëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua të sqaroi para juve se me Qarkoren buxhetore shpërndahen edhe kufijtë e buxhetit, tani ne si komunë i kemi njëmbëdhjetë mijë nxënës, këtë vitë i kemi 707 punëtorë në arsim, mësimdhënës dhe personel administrativ dhe teknik, norma për nxënës nga komunitetet sipas irregullave është 21 nxënës, ndërsa për nxënës në përgjithësi është 24 nxënës, për një normë. Por problemi këtu është se Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, e ndan buxhetin dhe e bënë premjen, për tri dhetë e katër mijë banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, thelbi i problemit këtu është zgjidhja ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit. Nga 186 norma të ndara me buxhetin e vitit 2023, vetëm 141 norma kanë shkuar në arsim.

Drejtori për Arsim: Tani dua të ju njoftoi juve për normat e kërkuar, me emailin e parë të vitit 2011, pastaj ne si Drejtori e Arsimit i kemi kërkuar 40 norma të reja. Njësoi kemi vazhduar edhe në vitet e tjera, por nuk kemi arritur ta kemi ndonjë zgjidhje të pranueshme nga niveli qendror deri tani.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim ‘Kërkesën për shfuqizim vendimin Nr. 07, të datës 07.02.2024, për lejimin e mjeteve financiare për punëtorët arsimorë nga kategoria e mallërave e shërbimeve apo subvencioneve dhe transfereve’.

U votua me: pesë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave nuk e aprovon ‘Kërkesën për shfuqizim vendimin Nr. 07, të datës 07.02.2024, për lejimin e mjeteve financiare për punëtorët arsimorë nga kategoria e mallësrave e shërbimeve apo subvencioneve dhe transfereve’.

Pika e tëtë (8) - Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban për përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal dhe zbatueshmërinë e Hartës Zonale të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Informatën e Drejtorisë së Planifikimit Urban për Planin Zhvillimor Komunal dhe realizueshmërinë e Hartës Zonale të Komunës’, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban, që të na jap sqarime shtesë, po ashtu i urojmë edhe marrjen e detyrës së re si drejtor.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë jam menaxher i kontratës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ku tani jemi në fazën e përshkrimit të gjendjes ekzistuese, e kemi përshkrimin e fushave përkatëse, pjesën tekstuale, hartografike, të përpunimit të materialit për fusha të caktuara, ku secili e bën furnizimin me të dhëna për Kompaninë ‘INSI’, ky plan sipas ligjit do të ketë një kohëzgjatje prej tetë vite e ardhshme, e cila ka filluar në mars dhe pritet të zgjatë tri dhjetë ditë, tani Plani Zhvillimor Komunal do të publikohet në ueb-faqe si projekt përmes një linku, për këtë punë duhet ta bëjmë edhe hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili i kërkon të njëjtat fazë dhe hapë rrugë për aprovin e Planit Zhvillimor Komunal, në muajin dhjetor e kemi realizuar një pagesë për Kompaninë ‘INSI’, në shumën e mjeteve financiare prej: 84,000.00€, mbetet për pagesë edhe shuma e mabetur e mjeteve financiare prej: 119,000.00€, sepse vlera është e ndarë në dy situacione.

Shpend Bardiqi: Tani a vlen kjo edhe për pagesën tjeter, a ka pasur edhe kontrata tjera kjo Kompani me komunën tonë.

Drejtori për Planifikim Urban: Po e njëjta Kompani e ka hartuar edhe ‘Hartën Zonale të Komunës’, në vitin 2020, një plan strategjik hartohet për tetë vite, ky plan do të vlen për periudhën 2024-2031, këtë hartim ne e bëjmë, sepse ‘Planit të vjetër zhvillimor’, i ka përfunduar mandati i zbatimit në fund të vitit 2023’. Një plan zhvillimor i parashev zhvillimet e përgjithshme për periudhën e ardhshme, të cilat duhet të harmonizohen me zhvillimet në teren sipas ‘Hartës Zonale të Komunës’.

Hasan Ismajli: Unë dua ta bëjë një pyetje, por mos e merrni si personale, vetë e the se jeni menaxher i projektit, e njëjta Kompani e ka përgatitur edhe Hartën Zonale të Komunës, a kanë informata të bollshme ata, a janë të pajisur me listën e pronave komunale apo jo, unë kam pyetur atje përgjigjëja e tyre ka qenë jo. Pastaj nëse e marrim rrjetin e kanalizimit ai është F 100, i ndërtuar në vitet e 80 ta, andaj në Planin Zhvillimor Komunal, duhet të dihet sa mabetet sipërfaqja e tokës bujqësore, duhet të kemi të qartë ku do të ndërtohen objektet shkolllore dhe objektet shëndetësore, ku do të bëhet zgjerimi i rrugëve, të cilat në raste të caktuara janë vetëm nga dy metra, sepse këtu dikush ka pasur fitim të madh, meqë ndërtimi në të ardhmen do të jetë në sipërfaqen 50% ndërtim dhe 50% sipërfaqe e lirë për banorët e asaj ndërtese.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në fazën e fundit, sepse në fund të vitit 2023 dhe fillim të vitit 2024, ka qenë një diskutim i hapur për këtë plan zhvillimor, i publikuar në ueb-faqen e komunës, por në këtë rast ka pasur shumë pak interesim.

Drejtori për Planifikim Urban: Secili nga dy mbëdhjetë anëtarët e Grupit Punues Komunal për fushën e vetë i dërgon të dhënët, te Kompania ‘Insi’, e cila e bënë vendosjen e tyre në Planin Zhvillimor Komunal.

Shpend Bardiqi: A ka kjo kompani konflikt të interesit, meqë i bënë dy e më shumë punë në Komunën e Fushë-Kosovës, si Planin e Mobilitetit të qëndrueshëm Urban për dy rrugë njëkahore, po ashtu tani edhe Planin Zhvillimor Komunal?

Drejtori për Planifikim Urban: Kjo Kompani është komani profesionale, që harton dokumente të tilla strategjike në pjesën më të madhe të Komunave të Kosovës.

Pika e tetë (8) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën ‘Pjetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtronjë pyetjet e tyre, nëse kanë për anëtarët e Ekzekutivit të Komunës.

Durim Hajra: Unë i kam dy pyetje për kontratat publike, njëra është për ‘Kontratën tre vjeçare për ndriçimin publik’, e lidhur në vitin 2022, ku është bërë pagesa e saj 80%, në dy mbëdhjetë muajt e parë të saj, lidhur me këtë unë kam kërkuar shpjegim dhe përgjegjësi, edhe në mbledhjen e kaluar. Çështja e dytë ka të bëjë me qentë endacakë, meqë kjo punë na preokupon të gjithëve, ku ka një tender shtesë, këtu kontrata është me shumë telashe. Drejtoria e Infrastrukturës e ka lidhur një kontratë për mbushjen e gropave me asfaltë, e cila është dhënë në vitin 2022, në shumën e mjeteve financiare prej: 77,000.00€, por gropat në rrugë janë mbushur me çimentë. Një kërkësë tjeter e kemi, për lokalet që janë afér Stadiumit të Futbollit ‘Ekrem Grajçevci’ në Fushë-Kosovë, këto lokale e kanë lejen e punës, por banorët e banesave për rreth aty po kanë shumë telashe pas orës 23:00h të natës, aty ka shumë zhurmë dhe dukuri negative, andaj ne kërkojmë që Drejtoria e Inspektoratit, të marrë masa për ndryshimin e gjendjes. Një pyetje tjeter e kam për tenderin i cili është në realizim, për renovimin e rrethojave në oborret e shkollave të fshatrave: Graboc i Poshtëm dhe Miradi e Epërme, pyetja këtu është a kemi të bëjmë me rrethoja të reja, sepse ku është edhe shqetësimi i banorëve në fshatin Miradi e Epërme.

Hasan Ismajli: Pyetjen e parë e kam për Shefin e Grupit Parlamentarë, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku këtu e kemi edhe Kryetarin e Partisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ndoshta kishte mundur që të na ndihmoj në përgjigje. Në mbledhjen e kaluar e kam ngritur një shqetësimë ku ka qenë tri vite me radhë, subvencionimi i studentëve serbë nga Drejtoria e Arsimit, ku këta studentë janë të institucioneve paralele dhe dokumentacionet e dorëzuara gjatë aplikimit janë nga Republika e Serbisë, si dhe Krahina Socialiste Autonome Kosova dhe Metohisë, Mitrovica e Kosovës, vendbanimi Fushë-Kosovë - Republika e Serbisë dhe është ajo vula me katër esa, ku edhe mburren me këta katër esa, që i kanë. Pyetja ime është çfarë qëndrimi keni ju si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për këtë çështje që janë subvencionuar për tri vite me radhë dhe a ju lejohet ky skandal. Pyetjen tjeter e kam për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, para një javë e kam pasur një familjar, i cili ka pasur probleme shëndetësore me zemër, i cili kishte shqetësimë se ka ndonjë paralajmërim të infraktit apo diçka tjeter dhe duke e ditur se sëmundja nuk zgjedh kohë, ne ishim në atë kohë prezant në Qendrën Keryesore të Mjekësisë Familjare, ndërsa komplet stafi i tyre në ora 9:00h ishte në pauzë dhe kjo për mua nuk ishte në rregull, sepse një mjek dhe një infermère, duhet të jetë çdo herë për raste emergjente në vendin e punës dhe që rastet emergjente të trajtohen. Ne është dashur që të presim deri sa të përfundoj pauza, unë të kam shkruar edhe në telefon, se kjo është duke ndodhur në Qendrën

shëndetësore. Ne është dashur që të presim derisa e kanë përfunduar pauzë për me ekzaminu pacientin. Po ashtu drejtori që është zgjedhur në Qendrën Shëndetësore prej se është ulur në atë karriken e tij, nuk po i largohet automjetit zyrtare, shkon dhe vjen në shtëpi me automjet zyrtare, ndërsa drejtori i kaluar, i cili ka mbajtur dy mandate në atë pozitë, nuk e ka përdorur asnijëherë automjetin zyrtar jashtë orarit të punës. Nënkyetar i Komunës kur ke ardhur në fillim ke marrë një vendim në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, ku keni dhënë një urdhëresë që automjetet zyrtare të shfrytëzohen vetëm gjatë orarit të punës, kjo ka zgjatur vetëm një ose dy muaj. Tani drejtorët edhe në mëngjes kur dalin shkojnë me automjete zyrtare dhe rrugat i kanë shumë më të mëdha, sesa zyrtarët të cilët udhëtojnë këmbë ose me autobus. Pyetjen tjetër e kam për Lëvizjen Vetëvendosje, a jeni në dijeni kolegë që tash ka filluar Drejtorin e Urbanizmit me shtruar asfalte nëpër oborre private?, kolegu z. Shpend Bardiqi në fshatin Pomozotin janë tri oborre private të cilët janë shtruar me asfalt. Nënkyetar i Komunës, e kam edhe një pyetje për ju: është një kontratë për vendosjen e kamerave nëpër qytet, kontratë në vlerë afér 500.000.00€ dhe ne nuk kemi informata, sa është çmimi i një kamere, se ku kanë me u vendos këto kamera në cilat lokacione, pastaj deri ku ka arrit projektit dhe kur përfundon ky projekt. Pyetjen tjetër e kam për objektin e komunës edhe pse brenda kanë përfunduar punimet dhe kanë hyrë punëtorët, mirëpo jashtë nuk ka fasadë, ku qëndron problemi? Drejtori i Administratës nuk është këtu, ku me datë 26.02.2024, ja kam dërguar një kërkesë për qasjen në dokumenta zyrtare për rastin e subvencioneve të studentëve serbë dhe asnijëherë nuk kamë marrë përgjigje. Unë kam shkuar në zyrën e Drejtorit të Administratës dhe më ka thënë se Drejtoria e Arsimit, nuk më ka kthyer përgjigje në lidhje me këtë dhe unë kur kam shkuar në Drejtorinë e Arsimit, ata më kanë treguar që kjo nuk ka shkuar naltë hiç.

Vlonjat Hasani: Këtu nga kolegu z. Hasan Ismajli u cekën bursat për studentët e komunitetit serb, problem këtu qëndron edhe te emërtimi, a janë apo jo këto bursa, unë dua të pyes kur do të bëhet shpallja publike për aplikimin e studentëve këtë vitë sepse kemi shumë pyetje, nga ana e tyre. Unë dua ta paraqes prapë çështjen e rregullimit të rrjetit të kanalizimit në rrugën ‘Lumi’ në fshatin Miradi e Epërme, meqë tani e kemi edhe ndërrimin e drejtorëve, shpresojmë që kjo punë do të rregullohet, sepse në atë pjesë të fshatit tonë, janë rrith një qind shtëpi të banimit. Një punë tjetër që dua ta ngriti tani është çështja e banesave sociale, që parashihet të rregullohen edhe me ‘Programin Tre vjeçar të Banimit’, këto banesa janë duke u keqë përdorur shumë, ato banesa shiten dhe jepen me qira në mënyrë të kundërligjshme, ndërrohen banorët aty, komuna për këto banesa ka obligime, por aty është krijuar një katrahurë. Në komunën tonë kemi raste kur bjen ashensori, andaj kërkojmë që të dalin Inspektorët në teren dhe të verifikojnë obligimet e ndërtuesve në këto raste. Pyetja tjetër ka të bëjë me mos funksionimin e ndriçimit publikë, i cili në disa rrugë të fshatrave tona ka nevojë për intervenim, njësoi është puna edhe te kontratat për asfaltimin e rrugëve në qytet. Ndërsa asfaltimi në rrugën e fshatit Sllatinë e Vogël, rruga për ‘Parkun e Pishave’, ne pyesim a vlen kontrata ende, sepse aty rruga nuk është kryer. Ne kërkojmë që Inspektorët e Komunës të dalin në teren në fshatin Miradi e Epërme, sepse në rrugën ‘Lumi’ po qarkullojnë kamionë që po hedhin mbeturina inerte, në atë pjesë të fshatit, kjo punë duhet të ndalohet.

Shpend Bardiqi: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sipas Ligjit për Shëndetësi, e ka për obligim publikimin e listës së barnave esenciale, që gjinden në stoqet e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, duhet ta vendosin në një ekran, në një vend të dukshëm në Qendrën shëndetësore. Ka dyshime se edhe barnat që janë në dispozicion

nuk u jepen pacientëve, ata duhet të dalin dhe t'i blejnë në barnatoret private. Është obligim i shëndetësisë primare që të jepen insulina, por edhe barna tjera kundër hepatitit janë bërë pa ndërrim të gjilpërave, ato nuk duhet të jepen falas. Kur do të kemi në funksion projektet që do të hartohen nga ‘Kompania për hartimin e projekteve’, sepse ne i kemi dhënë 260,000.00€, për dy rrugë një kahore në qytet.

Hasan Ismajli: Unë këtu dua ta jap një sqarim të sinqertë, lidhur me çështjen e kohës së pauzës, në Qendrën shëndetësore, nuk qëndron fare, sepse ne kemi pasur një rast të personit me probleme me zemër, kurse tani mua më shkruan doktor Remi, në lidhje me ngritjen si shqetësim të këtij rasti, unë them se ky është një rast familjarë i imi, për të cilin ne kemi kërkuar trajtimin e tij. Mua më kanë thënë se jemi në pauzë dhe s’kam dashur që të bëjë zhurmë, edhe pse ju kam shkruar juve në telefon e nderura Drejtoreshë e Shëndetësisë. Unë jam ulur dhe kamë pritur. Të kam shkruar në mënyrën më të sinqertë. Ju më keni thënë jam në dijeni për këtë çështje edhe më herët dhe e kam ngrit këtë shqetësim. Mirëpo ai i cili i ka shkruar Dr. Remit dhe i ka treguar se çka kamë thënë unë, kush është ai informator kishte qenë mirë me ditë ngjarjen, sepse kam qenë vetë prezent me familjarin tim dhe nuk e thashë rastë sishtë drejtoreshë, të kamë shkruar sepse kam dashur ta ngriti këtë çështje në Kuvend dhe për këtë arsyе të kam shkruar me datë 28.03.2024 në kohën e pauzës, i shef kamerat.

Arbnore Kelmendi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua ta ngriti çështjen e njëjtë, që e kam ngritur edhe në Kuvendin e kaluar, ku nxënësit vijnë me Kombibus në shkollë, këta kombi nuk lejohen të hyn në oborrin e shkollës ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë, ata janë tani duke u parkuar afér shkollës, por nxënësit janë të rrezikuar, sepse duhet të dalin jashtë oborrit të shkollës, unë e kam fëmiun tim aty, por e kërkoi një zgjidhje të arsyeshme për të gjithë nxënësit e lagjes së Nakaradës.

Nënkryetari i Komunës: Shkurt ne nuk do të injorojmë këtë çështje që u ngrit këtu nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Arbnore Kelmendi, unë kam informata se këtë punë e ka kërkuar Policia për arsyë të sigurisë, me një rekomandim. Ne nuk mund të sigurojmë parkingje për askënd në oborrin e shkollës, dua të jem konkret se këtë punë nuk kemi mundësi ta përmirësojmë. Tani ne jemi duke u marrë me Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, me përgatitjen e një ‘Projekt-Rregullore për Menaxhimin e Sallave të Sportit’, që gjinden në oborret e shkollave tona, të cilat duhet të shfrytëzohen nga klubet sportive dhe sportistët tonë, ku klubet e fshatit tjetër nuk mund ta shfrytëzojnë sallën në fshatin tjetër pa kompenzim, kjo pritet të jetë në këtë rastë natyra e vendim marries. Këtë punë e kemi vendosur duke komunikuar edhe me përfaqësuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës, pa i dëmtuar qytetarët dhe shkollat e futbollit, por me parimin e mbrojtjes së vendasve në fshatin e tyre, të cilët kanë të drejtën ta përdorin pa kompenzim sallën e tyre, ne këtë ide do ta paraqesim edhe nëpërmjet facebook-ut dhe rrjeteve sociale, për të kërkuar mirëkuptimin e të gjithëve, kërkojmë që këtë punë ta bëjmë në mënyrë racionale. Barnatoret që operojnë pa licencë, në komunën tonë duhet të mbyllen, jo me një aksion, por duhet të jetë proces i vazhdueshëm. A do të ketë bursa këtë vitë për studentët, po këtë punë do ta shpallim sa po të kemi buxhet nga të hyrat vetjake. Lidhur me banesat në fshatin Miradi e Epërme, nuk kam informata, nuk e kam ndonjë përgjigje. Lidhur me qasjen në dokumente zyrtare, nuk keni nevojë ta kurseni buxhetin e komunës, sepse paratë nga dënimet, nuk shkojnë në buxhet privat, por në buxhetin e shtetit, andaj unë ju inkurajoi që këto kërkesa nëse nuk keni marrë përgjigje, t’i dërgoni edhe në Agjensionin për Informim dhe Privatësi. U dhanë edhe vërejtje për ndërtimin e katit të

dytë në objektin e komunës, ‘Kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik’, është ndërprerë tani, andaj nuk kemi mundësi të intervenojmë në teren, kjo kontratë pas ankesës tani është në trajtim në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Lidhur me kërkesën për eliminimin e qenëve endacakë, ne i kemi pasur tri raste, kjo punë është problem, sepse qentë endacakë sjelljen në komunën tonë nga vende tjera, tani ne të gjithë i dijm kufizimet për këtë çështje, tani nxehet koha dhe këta qen janë me pak të acaruar, ne shpresojmë që kjo punë do të zgjidhet në nivel vendi, apo në nivel të Rajonit të Prishtinës, ku kemi takime për zgjdhjen e këtij problemi, edhe për qytetarët e komunës tonë, sepse vetë këtë punë nuk mund ta zgjidhim ne vetë, ku tani janë krijuar Grupe të përbashkëta punuese në kuadër të Agjensisë së Ushqimit dhe Veterinës. Kemi disa kontrata në zbatim, një projekt po merrë shumë kohë, zgjatë së paku 80 ditë, ne me kapacitetet tona në dispozicion po mundohemi, t’i mbikëqyrim ato. Tani te Kompania për hartimin e projekteve publike, e kemi dërguar projektin përrrugën ‘Naser Sekiraqa’ dhe për unazën e fshatit Lismir.

Drejtori për Planifikim Urban: Unë jam menaxher i ‘Kontratës për renovimin e rrëthojave në fshatrat: Graboc i Poshtëm dhe Miradi e Epërme, në oborret e shkollave ‘Laura Scotti’ dhe ‘Vellezërit Frashëri’, aty pozicioni është 320 metra gjatësi, ku rrëthojat sipas paramasës do të rregullohen me copa betoni, ku do ta rrëthojmë edhe fushën e futbollit, vetë banorët e fshatit kanë kërkuar gryerjen e gilindera të rrëthojës së vjetër, ku ka qenë sugjerim nga vetë fshati. Kontrata është përfunduar 99%, është bërë pagesa e parë. Lidhur me ashensorët, menaxhimi i tyre nuk është në kompetencën e komunës, por këtu duhet të verifikohet secili rast, pas marjes së certifikatës së përdorimit për një objekt banesorë, vetë Kompania punë kryese e ndërtimit, e ka obligim mirëmbajtjen e tyre një vjeçare, ashensori ka garacion një vitë, kjo nuk vlen për objektet banesore që nuk kanë pranim teknik, ka raste kur njerëzit hyn në ndërtesa pa u kryer pranimi teknik. Nëse në periudhën një vjeçare ndodh ndonjë avari, atëherë Inspektorët Komunal japin gjoba, kur hyn me para kontrata, kjo punë është e pa qenë dhe ne si komunë nuk kemi mundësi të veprimt. Për investimet e komunës në katin e dytë të komunës, kontrata e ka vlerën 450,000.00€, ne e kemi bërë një pagesë prej: 300,000.00€, ka mbetur të kryhet sipas kontratës fasada e jashtme dhe termo izolimi për ngrohje të këtij katë, jemi në këtë nivel, ku puna është e ndarë në dy fazë, ne duhet të bëjmë edhe pagesat tjera sipas kontratës së nënshkruar.

Hasan Ismajli: Unë pyes a ka rrezikshmëri për punëtorët e komunës, që janë vendosur në katin e dytë.


Drejtori për Planifikim Urban: Objekti është në gjendje të mirë, nuk janë vendosur shtylla në pjesën ku gjendet Zyra Pritëse, sepse nuk kanë qenë në projektin e caktuar, përndryshe në pjesët tjera nuk ka asnjë probleme në katin e ndërtuar, vetëm se në këtë pjesë nuk do të vendosen mobile dhe zyre për punëtorët e komunës, aty është një hapësirë e hapur.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sot këtu pati disa qëndrime të ashpëra pasi ‘Pyetjet dhe përgjigjet parlamentare’ janë bartur në fund të rendit të ditës, ju të gjithë e keni të qartë se rendin e ditës e bënë sipas ligjit Kryetari i Komunës me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, unë jam falenderues të gjithëve për mirëkuptimin dhe qëndrimin e juaj deri në fund, ku patëm diskutime për propozime gati një orë, ku në vazhdim u votua rendi i ditës së propozuar.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në ora 16:30 minuta.**

Procesmbajtës

Hasan Gjyreçi



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

